



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

---

Numri i lëndës: 2019:125565  
Datë: 23.04.2024  
Numri i dokumentit: 05607035  
C.nr.260/17

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ- Dega në Kaçanik, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Riza Livoreka, si gjyqtar individual, me sekretaren juridike Azemine Berisha, duke vendosur në çështjen kontestimore juridiko-civile të paditësit I. (I). L. , nga Kaçaniku Rr.”...”, Kaçanik, të cilin me autorizim e përfaqëson F. T., avokat nga Kaçaniku, kundër të paditurës Kompania “...”, me seli në Ferizaj, të cilën me autorizim e përfaqëson J. B. avokat nga Ferizaji, për çështjen kontestuese kompensimi i dëmit, në seancën kryesore të mbajtur me datë 25.03.2024, në praninë e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, ndërsa më datë 23.04.2024, bëri përpilimin me shkrimë të këtij:

A K T G J Y K I M

I. MIRATOHET kërkesëpadia e paditësit I. (I). L. , nga Kaçaniku Rr.”...” dhe DETYROHET e paditura Kompania “ ...”, me seli në Ferizaj, që paditësit, të ja pagua shumën prej 3.294.23€, në emër të kompensimit të dëmit material, në objektin e paditësit-shtëpinë e banimit P+2+NK, i ndërtuar në njësinë kadastrale ...ZK Kaçanik dhe rrethojnë mbrojtëse, në tërësi SI E BAZUAR.

Këtë shumë me kamat ligjore prej 8% , duke filluar nga data 25.03.2024 (nga data e seancës kryesore), deri ne pagesën definitive.

II. DETYROHET e paditura që paditësit të i’ a paguaj shumën si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 2,194,00€, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

## A r s y e t i m

I autorizuari i paditësit, si në padi ashtu edhe në seancat e mbajtura, ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e paditësit ta miratoj në tërësi si të bazuar dhe ta detyrojë të paditurën që paditësit të i'a paguajnë shumën prej 3.294,23€, në emër të kompensimit të dëmit material, në objektin e paditësit-shtëpinë e banimit P+2+NK, e ndërtuar në njësinë kadastrale ... ZK Kaçanik dhe rrethojnë mbrojtëse. Këtë shumë e ka kërkuar me kamat ligjore prej 8%, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive.

Ka theksuar se e paditura gjatë punimeve në ndërtimin e rrugës "...", në Kaçanik, ka ndërmarr veprime të atilla, sa që ka shkaktuar dëme material, në objektin e paditësit-shtëpinë e banimit P+2+NK, i ndërtuar në njësinë kadastrale ...ZK Kaçanik dhe rrethojnë mbrojtëse. Këto fakte janë vërtetuar nga provat të cilat gjinden në shkresat e lëndë, fotot dhe ekspertiza e grupit të ekspertëve.

I autorizuari ka theksuar se nga provat e administruara, e në veçanti nga ekspertiza e grupit të ekspertëve si dhe sqarimeve të bëra në seancë, është vërtetuar, se me fajin e të paditurës ka ardhur deri tek dëmi material në objektin e paditësit dhe rrethojnë mbrojtëse. Prandaj duke i pasur për bazë këto fakte të kontestuar, i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë ta miratoj si të bazuar dhe ta detyrojë të paditurën që t'ia paguajnë dëmin e shkaktuar.

Bazën Ligjore e ka mbështetur në nenin 136 të LMD-së, me të cilën dispozitë është paraparë se kush i shkakton dëm tjetrit duhet të i'a kompensojë. Prandaj nga këto baza i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta miratoj në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet i ka kërkuar.

E paditura, për mes të autorizuarit, si në përgjigjen në padi, ashtu edhe gjatë seancave të mbajtura, kërkesëpadinë e paditësit e ka kontestuar, si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia dhe i ka propozuar gjykatës që të refuzojnë në tërësi si të pa bazuar.

I autorizuari ka theksuar, se bazuar në të drejtën materiale, në nenet 136 dhe 137, të LMD-së, përcaktohen kushtet ligjore për shpërblimin e dëmit siç janë: të dihet personi që e ka shkaktuar dëmin, , të i jetë shkaktuar dëmi të dëmtuarit, të ekzistoj lidhja kauzale, në mesë të veprimit dëmtues dhe pasojës dhe veprimi të jetë i kundërligjshëm.

Tutje ka theksuar, se janë nxjerr dy ekspertiza nga lëmia e ndërtimtarisë edhe atë nga Eksperti F. M. dhe pastaj nga grupi i ekspertëve. Sipas ekspertizë së ekspertit F. M., faktorët që kanë ndikuar në dëmtimin e shtëpisë janë: ndërtimi i shtëpisë pa planë të statikes, ndryshimet , ndërhyrjet dhe shmangiet nga plani për ndërtimin e shtëpisë dhe përdorimi i materialeve jo adekuate dhe puna jo profesionale , të cilat kishin ndikuar në 80% të shkallës së dëmtimit. Pastaj faktor tjetër që ka pasur ndikim, në dëmtimin e objektit janë edhe faktori kohë, amortizimi i objektit, dhe aktivitetet e zhvilluara rrethë objektit gjatë ndërtimit të rrugës “ ...”, e të cilat fakte kanë pasur ndikim në shkallë prej 20%, të shkallës së dëmtimit.

I autorizuari tutje ka theksor, se nga ekspertiza e grupit të ekspertëve , është konstatuar se këto dëme janë shkaktuar, si pasojë e uljeve të objektit ndër vite , përbërja gjeologjike e tokës, plasaritjet kanë ekzistuar dhe para fillimit të punimeve në asfaltimin e rrugës, por të njëjtat janë zmadhuar gjatë punimeve në rrugë. Po ashtu eksperti S. B., të gjitha i ka sqrrur në seancën e datës 25.03,2024.

Prandaj nga te gjitha këto baza i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar.

Shpenzimet nuk i ka kërkuar.

Për ta vërtetuar gjendjen e plotë faktike dhe gjykuar drejtë këtë çështje kontestimore juridiko-civile gjykata me propozimin e palëve ndërgjyqëse në procedurën e provave bëri administrimin e këtyre provave të shkruara: u lexuan raporti për dëmtimin e objektit, i datë 23.05.2017, raporti i datës 02.06.2017, fotot e shtëpisë së dëmtuar, raporti i ekspertit L. D., CD e dorëzuar nga paditësi, sqarimet e bëra në seancë, kopja e planit, certifikata e pronës,, projekti, kontrata publike e datës 14.03.2017, ekspertiza e ekspertit F. M., sqarimet e bëra në seancë, ekspertiza e grupit të ekspertëve dhe sqarimet në seancë, pa vërejtje.

Pas vlerësimit me kujdesë dhe me ndërgjegje të provave në tërësi dhe të secilës veq e veq e në pajtim me dispozitat e nenit 7 dhe 8 të LPK-së dhe bindjes së lire të gjykatës, gjykata lidhur me këtë çështje kontestimore juridiko-civile vërtetoi këtë gjendje faktike:

Ngastra ku është shkaktuar dëmi, është në shfrytëzim të paditësit, paditësi në të ka të ndërtuar objektin e banimit me lokal afarist. Paditësi ka pësuar damë, sepse i janë qarë muret e

brendshme të shtëpisë dhe i është dëmtuar muri mbrojtës. Ky damë i është shkaktuar me veprimet e të paditurës të bëra gjatë gjurmimeve, ky damë arrijnë në vlerë prej 3.294.23€.

a) Se ngastra ku është shkaktuar dëmi, është në posedim të paditësit, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga certifikata e pronës me numër të njësisë 941-34458-2019, ku është shënuar se prona evidentohet në emër të Kuvendit Komunal Kaçanik, a shfrytëzues është paditësi, ky fakt nuk ishte kontestuese në mesë të palëve ndërgjyqëse.

b) se në këtë ngastër është e ndërtuar shtëpia e banimi, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës si dhe nga vendimet e Komunës së Kaçanikut dhe leja e ndërtimit. Po ashtu, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga fotot të cilat gjenden në shkresat e lëndës, si dhe ekspertizat e ekspertëve, të punuara gjatë kësaj procedure, ky fakt nuk ishte kontestua në mesë të palëve.

c) Se paditësi i është shkaktuar damë, i është dëmtuar shtëpia e banimit, lokali afarist dhe muri mbrojtës. Këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës edhe atë: nga ekspertiza e grupit të ekspertëve, të cilit kanë konstatuar se ka pasur qarje në themelet nga betoni, në murin nga blloqet e pjekura në kthesën e majtë, murin në këndin e majtë, të derës së hyrjes, në lokalin shikuar nga rruga "...". Pastaj në traun e betonit mbi derën e hyrjes së shtëpisë dhe në murin mbrojtës të oborrit, të punuar nga gurët natyral, ky fakt dokumentohet nga fotot e bashkangjitura.

Grupi i ekspertëve, ka konstatuar se në objektin e paditësit, kanë ekzistuar plasaritje të vogla, edhe para fillimit të punimeve, në asfaltimin e rrugës, por të njëjtat janë zmadhuar gjatë ekzekutimit të punimeve në hapjen e kanalit dhe pusetave për kanalizimin fekal dhe më shumë për shkak të ngjeshjes së rrugës me makineri të rënda.

ç) Ky damë është shkaktuar, me fajin e të paditurës, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga ekspertiza e grupit të ekspertëve dhe sqarimet e bëra në seancë, të cilit kanë deklaruar se pjesa kryesore e qarjeve janë shkaktuar nga ndërtimi i rrugës "...", në Kaçanik, ku me hapjen e kanalit, gjurmimit në thellësi mbi 2.5 m<sup>2</sup>, të kanali për fekalë, si kanalizim i rrugës "...", për pjesën e objekteve ndërtimore në këtë zonë, ka ardhur deri tek ky damë.

Gjykata pas analizimit të theksimeve të palës paditëse, provave të bashkangjitura në padi ekspertizës së ekspertit të ndërtimtarisë, plotësimi të bërë, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit

është e bazuar dhe e detyron të paditurën që t'ia paguaj dëmin si në pikën I të diapozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata shumë prej 3.294.23€, e ka caktuar duke u bazuar në ekspertizën e grupit të ekspertëve si dhe sqarimeve të bëra në seancën, të cilit kanë konstatuar se dëmi është shkaktuar gjatë ndërtimit të rrugës, duke punuar në rregullimin e rrugës dhe hapjen e kanalit në thellësi prej 2.5.m 2, kanalit për fekale- si kanalizim i rrugës, me makina të rënda gjatë gërryerjes në anën perëndimore, ku janë shkaktuar qarje, lëvizje të dheut dhe ka ardhur deri tek plasaritja e shtëpis dhe murit mbrojtës.

Meqenëse këto dëme janë shkaktuar me veprimin e paditurës, gjykata duke u bazuar në kontratën e punës, ka gjetur se e paditura ka marra për obligim, që të mos i dëmtoj objektet për rreth dhe do të jetë përgjegjëse për të gjitha aktivitetet në vend punishte. Prandaj gjykata duke i pasur për bazë këtë fakt e ka gjykuar shumën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi si dhe konform neni 136 të LMD-së.

Meqenëse e paditura, ka rënë në vonesë me kompensimin e dëmit, Gjykata me kërkesën e paditësit dhe në bazë të nen. 382 të LMD-së, e detyroi të paditurën që paditësit në shumat e gjykuara t'ia paguaj edhe kamatën vjetore prej 8%, duke fillua nga data 25.03.2024 (data e paraqitjes së padisë), e deri në pagesën definitive.

Gjykata i analizoi theksimet e palës paditëse, e cila i propozoi gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta miratoj si të bazuar. Këtyre theksimeve gjykata u a dha besimin, sepse nga ekspertiza e grupit të ekspertëve është konstatuar se dëmi është shkaktuar me veprimet e të paditurës, e cila i ka kryer punimet në ndërtimin e rrugës “...” në Kaçanik, duke bër hapjen-mbylljen e kanalizimit me gërmime të thella në tokë, shkaktimi i dridhjeve, ngjeshja e rrugës, lëvizjet e makinerive të rënda të automjeteve për ndërtimin e rrugës e nga të gjitha këto veprime janë bërë qarjet e mureve të brendshme të objektit të banimit dhe afarist si dhe qarja e murit mbrojtës për rreth pronës.

Gjykata i analizoi edhe pretendimet e të autorizuarit të paditurit, e cila i ka propozuar gjykatës, që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pa bazuar, sepse pretendimet e të paditurës nuk kishin ndikim që të vendosej ndryshe. Nga ekspertiza e grupit të ekspertëve, është vërtetuar se kush e ka shkaktuar dëmin, dëmi i është shkaktuar të paditurit, eksiton lidhja kauzale në mesë veprimit dëmtues dhe pasojës dhe veprimi është i kundërligjshëm. Këto theksime gjykata i

analizoi po nuk i mori për bazë me rastin e vendosjes sepse nga provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës e në veçanti nga grupi i ekspertëve, është konstatuar se deri tek qarja e mureve të brendshme të objektit afarist dhe të banimit ka ardhur për shkak të punimeve të kryera nga e paditura si dhe veprimeve tjera të cilat janë bër me rastin e lëvizjes së makinave në rregullimin e rrugës hapjen e kanalit si dhe mbushjen e kanalit.

Gjykata e obligoi të paditurën që paditësit të i'a kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 2,194,00€ edhe ate shumën prej 540€, për 4 përfaqësime nga ana e avokatit, 250€ për ekspertizën e ekspertit vlerësues të ndërtimtarisë dhe vlerësues dhe shumën prej 30 në emër të taksës për padi të parapara sipas Udhëzimit Administrativ për unifikimin e taksave gjyqësore si dhe konform nenit 451.1 LPKsë

## GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Dega Në Kaçanik

C.nr.152/18 prej datës 23.06.2021.

GJYQTARI

Riza LIVOREKA

### UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur, ka drejt të paraqes ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi të aktgjykimit. Ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit në Prishtinë ,përmes kësaj gjykate, në 3 kopje.

*Dërguar me datën 23.04.2024*

*Paditësit 1x1*

*Të paditurës 1x1*

Numri i lëndës: 2019:125565  
Datë: 23.04.2024  
Numri i dokumentit: 05607035